

DITARI MUJOR

MAJ 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

“YOUNG CELLS ALBANIA”, PIRDENI: ADMINISTRATA NË PROCES PËRTËRITJEJE PËR T’JU PËRGJIGJUR SFIDAVE TË INTEGRIMIT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni, Ambasadori i BE-s në Shqipëri Z.Silvio Gonzato dhe disa nga ambasadorët e vendeve të BE-së vendin tonë morën pjesë në eventin përmbyllës të projektit “Young Cells Albania”. Projekti i financuar nga BE, ‘Young Cells Albania’ kishte si qëllim përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe ekspertizës së 23 nëpunësve civilë të administratës publike, në administratat e vendeve të BE-së. Ministrja Pirdeni teksa vlerësoi projektin “Young Cells Albania”, tha se një prej reformave kryesore është ajo në Administratën Publike, për të ndërtuar në vijimësi aparatin e një sërë funksionarësh publikë me integritet, të cilët shërbejnë me shumë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm në funksionet publike.



MINISTRJA PIRDENI PËRFAQËSON SHQIPËRINË NË JAVËN EUROPIANE NË REGENSBURG TË GJERMANISË

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni ishte e ftuara e nderit në ceremoninë e hapjes së Javës Evropiane në Universitetin e Regensburgut në Republikën Federale të Gjermanisë. Java e Evropës e organizuar nga ky universitet këtë vit në fokus kishte Shqipërinë. Në panelin e organizuar në universitetin e Regensburgut, ministrja Pirdeni foli për të ardhmen evropiane të Shqipërisë, si dhe theksoi arritjet e rëndësishme dhe sfidat që e presin vendin për t’u bërë sa më shpejt pjesë e BE-së.



MINISTRJA PIRDENI MERR PJESË NË MBLEDHJEN E KOMITETIT KOORDINATIV KUNDËR KORRUPSIONIT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Koordinativ kundër Korrupsionit, ku bashkërisht me institucionet përgjegjëse dhe partnerë u diskutuan gjetjet e Raportit Vjetor të Monitorimit të Strategjisë së Antikorrupsionit për vitin 2023. Për të nëntin vit radhazi, raportet vjetore kanë matur progresin por edhe fushat ku duhet ende të angazhohemi të gjithë bashkërisht më shumë për të ngritur më solidë muret mbrojtëse ndaj korrupsionit në administratën publike, u shpreh gjatë fjalës së saj ministrja Pirdeni.



MINISTRJA PIRDENI NË TAKIMIN ME DIASPORËN NË MILANO: SOT SHQIPËRIA SHIKOHET ME RESPEKT NGA ALEATËT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni ishte e para që hapi fjalën e saj në takimin me diasporën në Milano, Itali. Pasi foli me fjalë zemre përpara bashkëkombasve për mikpritjen e jashtëzakonshme, ministrja Pirdeni përmendi transformimet që po ndodhin në administratën publike ku në fokus janë integriteti dhe ekselencia në performancë në avancimin e agjendës evropiane. Ministrja Pirdeni shtoi në fjalën e saj se shqiptarët prej tre dekadash i kanë dhënë Italisë atë që askush në Itali nuk mund ta imagjinonte dhe se sot Shqipëria shikohet me respekt nga aleatët.



DITARI MUJOR

MAJ 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

“JAVA E ADMINISTRATËS PUBLIKE” MINISTRJA PIRDENI: NJË ADMINISTRATË EVROPIANE PËR SHQIPËRINË, PO RIENERGJIZOHEMI!

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin me mbështetjen e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë çeli “Javën e Administratës Publike 2024: Modernizimi në veprim”.

“Panairi i Administratës Publike” hapi siparin e JAP për të celebruar shërbimin civil si një nga shtyllat e vendit, por edhe për të afruar qytetarët me administratën. Ministrja Pirdeni u shpreh se administrata shqiptare po rienergizohet për t’i shërbyer vizionit të Shqipërisë 2030. “Ne duam të jemi me ju, prandaj kemi sjellë në shesh administratën publike. Kështu krijojmë më tepër bashkëveprim jo vetëm me të gjithë qytetarët por edhe më ata të rinj të cilët duan t’i bashkohen administratës publike shqiptare. Motorët e vërtetë të këtij zhvillimi janë të gjithë ata zyrtarë e zyrtare publike, të cilët në përditshëmrinë e tyre i shërbejnë këtij funksioni por gjithashtu me shumë pasion dhe profesionalizëm kontribuojnë çdo ditë në progresin e vendit,” tha Pirdeni.



“JAVA E ADMINISTRATËS PUBLIKE”, ORGANIZOHET FORUMI I BURIMEVE NJERËZORE, PIRDENI: NË FOKUS ENERGJIZIMI I STAFEVE AKTUALE

Në kuadër të Javës së Administratës Publike, MAPA në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë, me DAP dhe ASPA organizuan Forumin e Burimeve Njerëzore. Fokusi kryesor i diskutimeve mes pjesëmarrësve ishte transformimi digjital i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore i cili do të sjellë unifikim procedurash, rritje të transparencës dhe përgjegjshmëri në administratën publike. Në fjalën e saj ministrja Pirdeni diskutoi për iniciativat konkrete digjitale, që do të çojnë në një tjetër nivel të gjitha proceset e punës për burimet njerëzore në administratë.




PR/REZOLUTA PËR ANTIKORRUPSIONIN, MINISTRJA PIRDENI: MUNDËSI PËR TË THELLUAR KONSOLIDIMIN E SHTETBËRJES DEMOKRATIKE

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni në fjalën e mbajtur në Parlament ku u miratua Rezoluta për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian. theksoi se projekt rezoluta për antikorrupsionin është një mundësi me rëndësi kritike për të thelluar konsolidimin e shtetbërjes demokratike dhe për t’i dhënë dimensionin e duhur dhe të merituar dhe tanimë tërësisht të prekshëm të Shqipërisë së 2030 në Bashkimin Evropian. Ministrja Pirdeni u shpreh se vendi është tashmë në një trajektore të pandalshme drejt ngritjes në një tjetër nivel të standardeve të mirëqeverisjes, luftës së pakompromistë kundër korrupsionit dhe sundimit të ligjit.



MODERNIZOHET ADMINISTRATA, MINISTRJA PIRDENI: FLEKSIBILITET ORARI, VLERËSIM PERFORMANCE DHE RITJE PAGASH

Ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni prezantoi “Paketën e Motivimit për Administratën” e cila përfshin, rritjen e pagave për vitin 2024, fleksibilitetin e orarit në punë, vlerësimin e performances së punonjësve si dhe një seri masash mbështetëse për mbarëvajtjen e punës në Administratë dhe trajtimin e punonjësve. Pirdeni theksoi se reformat e nisura kanë filluar të japin frytet e para, duke shndërruar sektorin publik si një punëdhënëse tërheqëse dhe shpërblyes. Ndryshimet vijnë me një valë të re të përqëndruar tek transformimi i institucioneve dhe modernizimi. Një pjesë thelbësore e këtij transformimi është “Paketa e Motivimit për Administratën Publike” që përfshin fleksibilitet të orarit të punës sipas nevojave që kanë punonjësit e administratës dhe përmirësim të kushteve të punës. Gjithashtu ministrja Pirdeni bëri me dije se pagat do të rriten brenda vitit 2024 për nënpunësit e nivelit specialist, për punonjësit e njësive të Vetëqeverisjes Vendore, ushtarakët, punonjësit e policisë dhe të arsimit



DITARI MUJOR

MAJ 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

12 EKIPET E MINISTRIVE MASIN "MUSKUJT" NË FUSHË, MAS FITON TROFEUN E PARË TË VOLEJBOLLIT TË AP

Fryma e ekipit nuk mund të shfaqej më bukur në turneun e Volejbollit, organizuar në kuadër të "Javës së Administratës Publike". Shpirti i garës doli në pah nga 12 ekipet e ministrive përgjatë një jave, të cilat u përballën në fushë me njëra-tjetrën. Në Parkun Olimpik "Feti Borova", në praninë e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni, Ministres së Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Mirela Kumbaro dhe kryebashkiakut të Tiranës Erion Veliaj u luajt ndeshja finale e Kampionatit të Volejbollit të Administratës Publike ku u përballën në një finale emocionuese Ministria e Arsimit dhe Sportit me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Trofeu i Volejbollit të Administratës Publike u fitua nga MAS.



FORUMI I INOVACIONIT NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT, MINISTRJA PIRDENI: DUAM TË MARRIM MË TË MIRËT E TREGUT!

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit në bashkëpunim me MEKI organizuan në kuadër të JAP, "Forumi i Inovacionit: Punësimi në sektorin publik dhe privat". Në qendër të diskutimeve ishin hapat e ndërmarra deri më tani nga administrata dhe sektori privat në Shqipëri për të përqafuar inovacionin në tregun e punës, si instrument esencial në rritjen e efikasitetit, konkurrueshmërisë dhe transparencës. Ministrja Pirdeni theksoi se Digjitalizimi, sot është një realitet i prekshëm i Administratës dhe se vitet e fundit është avancuar jashtëzakonisht në administratë sa i takon inovacionit dhe digjitalizimit, në mënyrën sesi ofrohen shërbime tek qytetarët. "Ne kemi nisur një iniciativë në fillim të këtij viti për të modernizuar aspekte të punësimit brenda sektorit publik. Si sektor publik duam të tërheqim më të mirët në treg, pra jemi konkurrent me sektorin privat," u shpreh ministrja Pirdeni gjatë fjalës.



"MERR FËMIJËN NË PUNË" ADMINISTRATA HAP DYERT PËR VOGËLUSHËT: NJË DITË NË PUNË ME PRINDËRIT!

Administrata Publike mirëpriti fëmijët e punonjësve të saj në një ditë të mbushur me gjallëri entuziazëm dhe aktivitete argëtuese. Eventi përmbyllës i JAP kishte për qëllim të afronte botën e punës së prindërve me fëmijët e tyre për të kuptuar se çfarë bëjnë konkretisht në pesë ditët e javës. Ministrja Pirdeni inkurajoi gjatë javës së "Administratës Publike" punonjësit që të sillnin fëmijët në punë, duke krijuar një mundësi për të njohur nga afër angazhimet e përditshme të prindërve të tyre në zyrat e ministrive dhe Kryeministrisë, me qëllim kultivimin e respektit për punën në një moshë të hershme. Kjo ditë e hapur pritet të shndërrohet në një traditë të përvitshme në administratën publike.



Ministër i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni